



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Zhalbe i Predstavake

Anr.328/2021

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Faton Ademi kryesues, Milena Đerić dhe Zyhdhi Haziri anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares së lartë ligjore Antigona Murati, duke vendlidur lidhur me apelin e parashtruar nga Iniciativa Qytetare “Komuniteti i Bashkuar– Adriana Hodžić”, me seli në Mitrovicë e Veriut, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të miratimit të listës së Kryesuesve dhe Anëtarëve të Këshillave të Vendvotimeve (KVV), për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur më datë 08.02.2021, mori këtë:

### V E N D I M

Hedhet i palejuar apeli Anr.328/2021 i datës 04.02.2021, i ushtruar nga Iniciativa Qytetare “Komuniteti i Bashkuar– Adriana Hodžić”, me seli në Komunën Mitrovicë e Veriut, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, për emërimin e përbërjes së Këshillave të Vendvotimeve (KVV).

### A r s y e t i m

Me datën 04.02.2021, Iniciativa Qytetare “Komuniteti i Bashkuar” – Adriana Hodžić, ka paraqitur apel në PZAP, në të cilin pretendohet se Komuniteti Boshnjak, është i përfaqësuar territorialisht në Komunën e Mitrovicës Veriore, me një përqindje prej gati 50%, në raport me popullatën Shqiptare në Komunën e Mitrovicës së Veriut dhe Komuniteti Shqiptarë ka marrë 77 anëtarë në Komisionet e Qendrave të Votimit, ndërsa Iniciativa e tyre Qytetare ndërsa Iniciativa Qytetare “Komuniteti i Bashkuar”– Adriana Hodžić, nuk mori asnjë sipas formulës së re. Në vazhdim të apelit theksohet se në rezultatet e vitit 2019 në Mitrovicën e Veriut, AAK-ja mori 80 vota dhe bazuar në at, tani ka 90 anëtarë të komisionit të qendrave të votimit. Iniciativa në fjalë kërkon të sqarohet se në bazë të cilit kriter këto përqindje janë miratuar në komisionet e votimit ndërsa ekzistojnë iniciativa qytetare në jug të Kosovës, të tillë sinë Graçanicë, Kllokot, Shtërpçë, ku është aprovuar pjesëmarrja e tyre (Anëtarët e Komisionit të Votimit) edhe pse ata garojnë për herë të parë në procesin zgjedhor, pra Zgjedhje. Mëtutje pretendohet se në ftesën e KQZ-së për nominime thuhej se gjithsesi të merret parasysh përfaqësimi etnik i popullsisë në komuna të ndjeshme dhe komuniteti boshnjak është i përfaqësuar në këtë komunë më shumë se sa në ndonjë tjetër në të katër komunat veriore. Sipas informacionit, KKZ-ja e komunës së Mitrovicës Veriore ka miratuar një formulë me tetë vota pro dhe një votë kundër, dhe sipas asaj formule

iniciativa e tyre qytetare pretendon se kishte 10 kandidatë për anëtarë të komisionit të votimit ndërsa sipas formulës së re që kanë sjellë, tani nuk kanë asnjë anëtar të komisionit të votimit. Parashtruesja e apelit pretendon se kjo qasje është një shembull klasik i diskriminimit ndaj komunitetit boshnjak dhe rishpërndarja e tyre e re e komisioneve të votimit është tendencioze dhe nuk fut besim në një proces vërtet demokratik. Në vazhdim pyesin se kujt i pengon pjesëmarrja e komunitetit boshnjak në komisionet e votimit dhe rregullsia e procesit zgjedhor vihet në pikëpyetje, veçanërisht gjatë numërimit të votave, sepse nuk do të kenë njerëzit e tyre gjatë aktit të numërimit.

Iniciativa Qytetare “Komuniteti i Bashkuar” – Adrijana Hodzic kërkon të veprohet në mënyrë të barabartë dhe në përputhje me ligjet në fuqi në Republikën e Kosovës, të ju sigurohen të drejta të barabarta dhe pjesëmarrje të barabartë në zgjedhje. Me propozim që ti pranohet kërkesa e tyre për miratimin e një formati të ri në komisionet e votimit në komunën e Mitrovicës së veriut që do të jetë i pranueshëm për ta.

Paneli, pasi që shqyrtoi lejueshmërinë e apelit, gjeti se:

#### **Apeli është i palejueshëm**

Me nenin 63 paragrafi 3 i LZP-së, përcaktohet se: “*Vendimi i Komisionit nuk i nënshtrohet ankesës, përveç nëse nuk parashihet qartë me këtë ligj*”.

Me nenin 64 paragrafi 2 pika a) i LZP-së, përcaktohet se: “*KQZ-ja i përgatitë dhe shpall rregullat, format dhe procedurat zgjedhore që kanë të bëjnë me zbatimin e këtij ligji dhe me çdo çështje tjeter që ka të bëjë me drejtimin e zgjedhjeve në kuadër të kompetencës së saj*”, ndërsa me pikën b) të këtij nenit përcaktohet se: “*KQZ-ja, i publikon të gjitha rregullat e miratuara, udhëzimet dhe procedurat zgjedhore dhe i bënë ato të arritshme për opinionin*”.

Apelimet zgjedhore ndaj vendimeve të KQZ-së, në PZAP, janë përcaktuar me nenin 122 paragrafi 1 pikat: a) b) c) d) e) dhe f) të LZP-së, në të cilat përcaktohet se:

- a) *Përfshirjen ose largimin e një personi për të marr pjesë në programin votues brenda dhe jashtë Kosovës;*
- b) *Certifikimin ose kundërshtimin për të certifikuar një subjekt politik ose kandidat për të marrë pjesë në zgjedhje;*
- c) *Kandidati i cili pas certifikimit nuk dëshiron të marrë pjesë në zgjedhje;*
- d) *akreditimin ose refuzimin për akreditim të një vëzhguesi zgjedhor;*
- e) *vendosjen e një gjobe administrative ndaj një subjekti politik sipas nenit 42 të këtij ligji dhe*
- f) *Refuzimin për të regjistruar një parti politike brenda Zyrës.*

Nga interpretimi i dispozitave të lartëkura rezulton se vendimet e KQZ-së, nuk janë të apelueshme përveç nëse parashihen qartë më ligj. Në këtë rast vendimi i apeluar i KQZ-së, nuk hynë në kategorinë e vendimeve të cilat mund të apelohen e të cilat janë të përcaktuara në mënyrë taksative në nenin 122 paragrafi 1 pikat a), b) c), d), e) dhe f), për arsy se vendimi i apeluar hynë në kategorinë e vendimeve të karakterit teknik menaxhues të KQZ-së, e i cili

vendim është nxjerrë në pajtim të plotë me nenin 64 të LZP-së, e i cili vendim nuk prek apo cenon një të drejtë themelore të votuesve.

Meqenëse vendimi i apeluar siç u cek më lartë hynë në kuadër të vendimeve teknike organizative, Paneli nuk u lëshua në vlerësimin meritор të çështjes, pasi vlerësoi se ky vendim nuk mund të apelohet për arsyet e cekura më lartë.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me nenin 118 të LZP-së dhe nenin 11 paragrafi 5 të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, Nr.02/2015, Paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa**

Anr. 328/2021 më datë 08.02.2021

**Kryesuesi i Panelit**

Faton Ademi



**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi nuk e lejuar ankesa, në kuptim të nenit 118 paragrafi 4 i LZP-së.